



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Rruga "28 Nëntori", nr. 1 Shkodër (Albania)

V E N D I M

Nr. 12, datë 29.07.2022

PËR SHPALLJE DËSHMOR I ATDHEUT (Pas Vdekjes)

PËR

TON NDRECË JAKINI

Këshilli i Qarkut Shkodër i mbledhur sot më datë 29.07.2022, merr në shqyrtim relacionin mbi projekt vendimin "Për propozimin për shpallje Dëshmor i Atdheut për Ton Ndrecë Jakini, paraqitur nga Administrata dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 109/2018, datë 20.12.2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut"; në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15, vendimit në Komisionin e Vlerësimit të Figurave dhe Kryesisë së Këshillit të Qarkut;

Pas diskutimit nga drejtoria e zhvillimit dhe bashkëpunimit me jashtë dhe pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit të fshehtë ku u Miratua me **12 Vota Pro, 0 Vota Kundër**. Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër,

V E N D O S I:

I. T'i propozojë apo jo Komisionit Qendror pranë Ministrisë së Mbrojtjes shpalljen:

"Dëshmor i Atdheut" për: **TON NDRECË JAKINI**, me këtë motivacion:

"Rënë në krye të detyrës për shkak të cilësive të veçanta, në përpjekje për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike".


II. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari dhe Administrata e Këshillit të Qarkut Shkodër.

III. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETARI

Hilmi LAKTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



RELACION

PROPOZIM PËR SHPALLJE DËSHMOR I ATDHEUT PER TON NDRECË JAKINI

Këshilli i Qarkut Shkodër i mbledhur sot më datë 29.07.2022, merr në shqyrtim relacionin dhe projekt vendimin “Për propozimin për dhënie “statusi Dëshmor i Atdheut”, të përgatitur nga administrata dhe paraqitur nga Kryetari i Këshillit të Qarkut, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në Ligjin Nr. 109/218 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”;

Sipas Ligjit Ligjin Nr. 109/218 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”; neni 5, Kriteret për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Dëshmorë mund të shpallen apo u njihet statusi si i tillë, Shtetasit shqiptare, të cilët vriten për shkak të detyrës shtetërore që kanë kryer, në luftë kundër krimit dhe përpjekjeve për vendosjen e rendit dhe të qetësisë publike.

Në përputhje me dispozitat ligjore të mësipërme dhe në zbatim të tyre si dhe në kërkesën e paraqitur pranë Këshillit të Qarkut Shkodër, pas një shqyrtimi që iu bë materialeve që janë konform kriterëve ligjore të siguruara nga familjaret dhe vete komisioni qendror për statusin e “Dëshmorit të Atdheut”, paraqesim këtë propozim për shqyrtim të mëtejshëm për t’i propozuar Komisionit Qendror të Statusit Dëshmor i Atdheut, për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” për :

TON NDRECË JAKINI,

Ton Ndrecë Jakini, lindur dhe banues në fshatin Hajmel, Shkodër, efektiv i Komisarariatit të Policisë Shkodër, deri me datë 18.05.2010;

Gjendja gjyqësore, i padënuar me parë dhe gjendja familjare i martuar me katër fëmijë;

Ka kryer shkollën e mesme të përgjithshme “Ndre Mjeda”, në Mjedë në vitin 1988;

Ka filluar punë në strukturat e Policisë me detyrën Trupë Shërbimi në Vau Dejës, në Komisariatin e Policisë Shkodër në Gusht të vitit 1993;

Del në lirim para kohe me datë 07.04.1994;

Ri-pranohet me datë 03.01.1995 dhe caktohet me detyrë Trupë Shërbimi;

Me urdhër 1714, datë 09.11.206 të Drejtorit të Policisë së Qarkut, emërohet Përgjegjës i Patrullës Shqiponja, në seksionin e Policisë Rendit, në Komisaratin e Policisë Shkodër, Drejtoria e Policisë Shkodër.

Me urdhër nr. 37, datë 15.01.2009 të Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër, transferohet dhe caktohet Trupë Shërbimi e shofer (oficer i Patrullës së Përgjithshme) në stacionin e Policisë Bushat. Me datën 18.05.2010, gjatë kryerjes së shërbimit, në Postën e Policisë Bushat është qëlluar me arme zjarri dhe për pasoje ka gjetur vdekjen.

Ka një kërkesë nga e shoqja e të ndjerit Ton Jakini, Gjyle Jakini për përfitimin e statusit të Dëshmorit të Atdheut pasi i ndjeri është vrarë gjatë kohës së kryerjes së detyrës, pasi ka qenë polic në Policinë e Shtetit.

Menjëherë i është kërkuar informacion nga Këshilli i Qarkut Drejtorisë Vendore të Policisë për rastin në fjalë si dhe një mendim të tyre në lidhje me këtë kërkesë, me shkresën 813/1, datë 21.11.2019; Me shkresën 8630/1, datë 08.01.2020, ka një kthim përgjigje nga ana e drejtorisë së Policisë.

Mbi bazën e kësaj shkrese është kthyer një përgjigje palës së interesuar me shkresën 813/3, datë 14.01.2020, mbi bazën e dokumentacionit që kishim në dispozicion.


Vlen të thuhet se pas daljes së ligjit në vitin 109/2018, duhet të nxirreshin dhe aktet në zbatim të tij sa i përket Formatit të kërkesës, llojet e dokumenteve, që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit “Dëshmor i atdheut”, si dhe kushtet teknike të plotësimit, të cilat akoma nuk kanë dalë;

Pala e interesuar ka dërguar çështjen pranë Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, i cili pasi e ka hetuar në hollësi, ka kërkuar dokumentacion shtesë nga organet e specializuara, e kthen kërkesën për shqyrtim pranë Këshillit të Qarkut Shkodër, për të gjykuar nëse rrethanat e humbjes së jetës së të ndjerit Ton Ndrecë Jakini, janë në përputhje me kriteret për tu propozuar për tu shpallur “Dëshmor i Atdheut”, pranë Komisionit të Statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Kërkesa në fjalë ka kaluar dhe procedurën e vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Figurave pranë Këshillit të Qarkut Shkodër, pjesë e të cilit ishin dhe drejtuesit e Komisariateve të Policisë, Shkodër dhe Vau i Dejës, bashkangjitur shkresa).

Duke shpresuar në miratimin nga ana Juaj,

Nëpunësi
Andrea Jakova



KRYETARI
Hilmi LAKTI

